



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:176774

Datë: 03.08.2023

Numri i dokumentit: 04551519

Rev.nr.239/23

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Rrustem Thaqi, kryetar i kolegjit, Beshir Islami dhe Zenel Leku, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore të paditësit: B. H. nga Fshati P., Komuna S., Lagja ..., rr. “...” nr..., kundër të paditurës: N. C. F. LLC, me seli në D., të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i autorizuar Blerim Prestreshi avokat në P., sipas autorizimit, për kthim në vendin e punës dhe kompensimin e pagave, duke vendosur lidhur me revizionin e paditësit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.416/2021, të datës 04.05.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 31.07.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si i pa bazuar revizioni i paditësit: B. H. nga Fshati P., Komuna S., Lagja ..., rr. “...” nr..., i paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.416/2021, të datës 04.05.2023.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Glllogoc, C.nr.257/2019 të datës 17.12.2020, është vendosur: I. Hedhet padia e paditësit B. H. nga Fshati P., Komuna S., Lagja ..., rr. “.....” nr..., kundër të paditurit N. C. F. LLC, me seli në D., lidhur me kthimin në vendin e punës dhe kompensimin e pagave nga viti 2013 e deri më tani si e pasafatshme. II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Gjykata e Apelit e Kosovës me aktvendimin Ac.nr.416/2021, të datës 04.05.2023, ka vendosur që të: Refuzohet ankesa e paditësit B. H. nga Fshati P., Komuna S., vërtetohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Glllogoc, C.nr.257/2019 të datës 17.12.2020.

Kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit, në afat ligjor ka paraqitur revizion paditësi, pa cekur ndonjë bazë ligjore konkrete, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, të pranojë si të bazuar revizionin, të prishet aktgjykimi i shkallës së dytë dhe aktgjykimi i shkallës së parë dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Përgjigje në revizion nuk ka pasur.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se:

Revizioni i paditësit është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi më datë 07.06.2019, ka parashtruar padi ndaj të paditurit, për kthim në vend pune dhe kompensimin e pagave nga viti 2013 e deri më tani, duke kërkuar më saktësisht si në kërkesëpadi.

Gjykata e shkallës së parë, duke vendosur sipas padisë së paditësit kundër të paditurës, pas vlerësimit dhe administrimit të provave, jashtë seancës gjyqësore ka nxjerr aktvendimin e atakuar C.nr.257/2019 të datës 17.12.2020, me të cilin e ka hedhë poshtë padinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata e shkallës së parë ka theksuar se: gjykata e shkallës së parë ka marr aktvendim e goditur të përshkruar si në dispozitiv, duke gjetur se padia e paditësit është e pasafatshme, sepse paditësit marrëdhënia e punës i është ndërprerë më datë 01.03.2013, ndërsa paditësi me kërkesë të pa protokolluar më datë 07.03.2013, ka kërkuar nga i padituri të shqyrtoj vendimin e saj, ndërsa deri më datë 07.06.2019, kur ka ngritur padi në Gjykatën Supreme të Kosovës nuk ka marrë asnjë veprim për mbrojtjen e të drejtës së tij gjyqësore rreth çështjes së kthimit në vendin e punës, prandaj padia e paditësit është paraqitur me vonesë prej 6 vite e 3 muaj e 6 ditë, e bazuar në dispozitat e neneve 78, 79 dhe 87 të Ligjit të Punës. Vendimi për shpenzimet e procedurës kontestimore bazohet në nenin 450 të LPK-ës.

Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë paditësi ka paraqitur ankesë, ndërsa gjykata e shkallës së dytë me aktvendimin e saj Ac.nr.416/2021, të datës 04.05.2023, ka vendosur që të refuzojë ankesën e paditësit, ndërsa aktvendimin e atakuar, ta vërtetojë, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit.

Gjykata e Apelit pasi ka ekzaminuar aktvendimin e goditur gjenë se aktvendimi i goditur nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 194 e lidhur me nenin 182 par. 2 pika b), g), j), k) dhe m), në të cilat kjo gjykatë shikon sipas detyrës zyrtare, e as në ato në të cilat thirret ankesa. Kjo për faktin se aktvendimi nuk ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet. Dispozitivi i aktvendimit është i kuptueshëm dhe nuk është kontradiktor me vetveten e as me arsyet e aktvendimit dhe në të janë dhënë arsye për faktet vendimtare e të cilat arsye i pranon edhe kjo gjykatë.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë dhe gjykatës së shkallës së dytë, pasi që aktvendimi nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore

dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat Gjykata Supreme, në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Supreme e Kosovës, e ka pranuar qëndrimin e gjykatës së shkallë së parë dhe gjykatës së shkallës së dytë edhe për zbatimin e të drejtës materiale, duke vlerësuar se në përputhje me gjendjen faktike të provuar e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, për arsye se:

Afatshmëria e padisë në kontestet nga marrëdhënia e punës lidhur me të drejtat nga marrëdhënia e punës, përfshirë ndërprerjen e marrëdhënies së punës, apo ndryshimit të vendit të punës, apo çfarëdo të drejta tjetër lidhur me statusin e punëtorit nga marrëdhënia e punës, duhet që gjykata të kujdeset sipas detyrës zyrtare nëse kërkesa është ushtruar konform dispozitave të nenit 78 dhe 79 të Ligjit të Punës të Kosovës.

Gjykata Supreme e Kosovës, i ka vlerësuar me kujdes pretendimet e paditësit të paraqitura në revizion, mirëpo të njëjta janë të pabazuara, për faktin se afatet e përcaktuara me nenin 78 dhe 79 të Ligjit të Punës, janë afate prekluzive, dhe të njëjtat afate nuk mund të zgjaten dhe as të shtyhen, në rast të kalimit, padia është gjithmonë e pasafatshme, pa marrë parasysh arsyet e lëshimit të afatit.

Me nenin 391 paragrafi 1 pika f) e LPK-së, përcaktohet se: “ Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme, po që se konstaton se:... padia është paraqitur pas skadimit të afatit po që se me dispozitat e posaçme është parashikuar afati për paraqitjen e saj ”.

Me nenin 78 paragraf 1 të Ligjit të Punës me numër 03/L-212, përcaktohet se: “ I punësuar i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës mund të paraqes kërkesë të punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit për realizimin e të drejtave të shkelura ”, me paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se: “ punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit në afatin brenda 15 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës ”, ndërsa me neni 79 të këtij ligji përcaktohet se: “ Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se janë shkelur të drejtat e tij ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragraf 2 të këtij ligji, në afatin vijues prej 30 ditësh mund të inicioi kontest pune në gjykatën kompetente ”.

Me nenin 79 të Ligjit të Punës, përcaktohet se: “ Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2, të këtij ligji, në afatin vijues prej 30 ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente ”.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore në këtë rast por edhe në rastet kur paraqitja e padisë lidhet me afat, gjykata është e detyruar që fillimisht ta vlerësojë lejueshmërinë - afatshmërinë e padisë. Në kuptim të afatit që përcaktohet me dispozitat e cekura më lartë, rrjedhë se padia e paditësit për kthimin në vendin e punës dhe kompensimin e pagave nga viti 2013 e deri më tani, është e pa lejuar - gjegjësisht e pasafatshme, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësi padinë në Gjykatën Supreme e ka paraqitur më datë 07.06.2019, ndërsa marrëdhënia e punës i është ndërprerë më datë 01.03.2013, ndërsa paditësi me kërkesë të pa protokolluar më datë

07.03.2013, ka kërkuar nga i padituri të shqyrtoj vendimin e saj. Me vendimin Nr. Prot. .. të datës 01.03.2013, është vendosur që të: punësuarit B.H. i caktuar në punët dhe detyrat e punës si për mirëmbajtjen elektrike në Oborr të X. në Departamentin e Mirëmbajtjes - Elektrike i ndërprehet marrëdhënia e punës më datën 28.02.2013 për shkak të skadimit të afatit të kontratës. I punësuari ka të drejtë në pagë deri më datën 28.02.2013 kur ka skaduar kontrata, ndërsa padia në Gjykatën Supreme është paraqitur më datën 07.06.2019, nga rrjedh se prej datës kur e paditura ka marr vendim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës paditësit, e deri në paraqitjen e padisë kanë kaluar 6 vite e 3 muaj e 6 ditë, në këtë kontekst rrjedhë edhe përfundimi se padia është paraqitë pasi ka kaluar afati ligjor për paraqitjen e padisë, çka do të thotë se padia e paditësit në këtë rast është e pa lejuar.

Në kuptim të arsyeve të paraqitura në arsyetimin e aktvendimit të gjykatës së shkallës parë dhe gjykatës së shkallës së dytë dhe vlerësimeve të sipër theksuara, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Gjykatat e instancave më të ulëta dhe as gjykata sipas revizionit nuk kanë mundur ta vlerësojnë ligjshmërinë e vendimeve, për shkak se padia ka qenë e pasafatshme. Afatëshmëria e padisë është prezumim procedural nga i cili varet lejueshmëria e padisë dhe në mungesë të plotësisë të këtij prezumimi gjykata nuk mund të lëshohet në themelësinë e kërkesëpadisë.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me nenin 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Rev.nr.239/23, datë 31.07.2023

Kryetar i kolegjit
Rrustem Thaqi